



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

P- 073/11

Prishtinë, më 4 qershor 2009, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 4 QERSHOR 2009

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 101 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Nuk pati asnjë propozim për amandamentim të rendin të ditës.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Zgjedhja e Avokatit të Popullit

Kryetari njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me Rregullat e procedurës të Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, ka shqyrtuar propozimin e Panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar emrat e tre (3) kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit, të renditur sipas alfabetit të mbiemrit.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni** tha se në baze të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit dhe se bashku me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, nga radhët e grupeve parlamentare në komisione, në pajtim me rregullat e procedurës së Kuvendit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit është formuar Paneli rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit. Paneli rekrutues është udhëhequr nga deputeti Ibrahim Makolli. Kriteret kanë qenë unike për të gjithë kandidatët, të cilat janë hartuar në konsultim me ekspertët e Zyrës së Komisionarit të Lartë të OKB-së, të Zyrës së Sekretariatit të Këshillit të Evropës, si dhe në praninë e vëzhguesve të Shoqërisë Civile, OSCE, KMDL NJ, Zyra e Komisionarit të Lartë të OKB-së, Qendra për të Drejtat e Njeriut e UP, përfaqësuesit e EULEX-it, Zyra Civile Ndërkombëtare. Paneli i ka intervistuar, veç e veç, të gjithë kandidatët për Avokat të Popullit. Paneli, pas intervistimit të të gjithë kandidatëve ia ka paraqitur Raportin me rekomandime Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar Raportin e Panelit intervistues, i cili ka propozuar tre (3) kandidatë për pozitën e Avokatit të Popullit, të radhitur sipas alfabetit të mbiemrit. Komisioni e mbështet Raportin e Panelit intervistues.

Kryetari ftoi kryetarët e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues.

Grupi Parlamentar i PDK-së propozoi deputeten Elheme Hetemi,
Grupi Parlamentar i LDK-së propozoi deputetin Armend Zemaj,
Grupi Parlamentar i AKR-së propozoi deputeten Suzanë Novoberdaliu,
Grupi Parlamentar i AAK-së propozoi deputetin Rasim Selmanaj,
Grupi Parlamentar i LDD-së propozoi deputetin Naser Rugova,
Grupi Parlamentar i “7+” propozoi deputetin Enis Kervan,
Grupi Parlamentar i SLS-së propozoi deputetin Etem Arifi.

Kryetari tha se Komisionin votues duhen ta mbështesin edhe nga dy (2) zyrtarë të stafit civil të administratës së Kuvendit.

Pas formimit të Komisionit votues, Kryetari ftoi një nga një deputetët e Kuvendit, sipas radhës së alfabetit, që të votonin për Avokatin e Popullit.

Votimi ishte i fshehtë, me fletëvotime.

Pas përfundimit të procesit të votimit dhe të numërimit të votave, deputeti Enis Kervan, në emër të Komisionit votues paraqiti rezultatin e votimeve, si vijon:

Për pozitën e Avokat të Popullit kanë votuar 107 deputetë. Të pavalidshme janë pesë (5) fletëvotime.

- Për Sami Kurteshin kanë votuar 65 deputetë,
- Për Besnik Osmanin kanë votuar 27 deputetë, dhe
- Për Veton Vulën kanë votuar 10 deputetë.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

për zgjedhjen e Avokatit të Popullit

1. **Sami Kurteshi**, zgjedhet Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës.
2. Mandati i Avokatit të Popullit zgjatë pesë (5) vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 11:23 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**